

Plan veprimi për të garantuar të drejtën për informim në Shqipëri.

Rekomandime për të kontribuar në “Dialogun e Strukturuar për Lirinë e Medias” midis BE-së dhe Shqipërisë.

Hyrje

Niveli i lirisë së shtypit në Shqipëri, i klasifikuar si një nga më të ulëtët në Europë dhe në Ballkan, është në përkeqësim prej njëkohe të gjatë. Shqipëria është renditur në vendin e 99-të nga 180 vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit, të hartuar nga Reporterët pa Kufij (RSF) në vitin 2024. Gjatë Konferencës për të drejtën e informimit, e organizuar nga RSF dhe Këshilli Shqiptar i Medias në prill 2024, u identifikuan çështjet kryesore si më poshtë:

- Profesionistët e medias janë rregullisht viktimë të sulmeve të dhunshme, përfshirë ndonjëherë edhe ato fizike, por në shumicën e rasteve janë viktimë të sulmeve verbale, si dhe të presioneve ligjore, duke përfshirë paditë abuzive ligjore (SLAPPs), dhe përpjekjet e paligjshme për t'u zbuluar burimet;
- presionet ekonomike mbi mediat çojnë në pasiguri në punë për gazetarët, gjë që ndikon në aftësinë e tyre për të raportuar lirshëm e në mënyrë të pavarur, dhe nxisin vetëcensurën;
- aksesimi në informacionin me interes publik është shpeshherë subjekt i pengesave të pajustificuara nga administrata publike;
- modeli ekonomik i medias, i bazuar në reklama, minon pavarësinë e saj nga interesat e biznesit, ndërkohë që burimet alternative të të ardhurave (p.sh., abonimet) nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm;
- bashkëpunimi i rrënjësor thellë midis interesave të politikës, biznesit dhe medias në vend, ndikon shumë në pavarësinë editoriale dhe aftësinë e gazetarëve për të kryer investigime;
- procedura për emërimin e drejtorit të RTSH-së nuk është e lirë nga ndërhyrjet politike dhe ka mungesë transparence;

- tregu mediatik është i përqendruar në duart e një numri të vogël pronarësh/familjesh, duke kufizuar zhvillimin e një peizazhi mediatik pluralist;
- dobësimi i praktikave editoriale dhe standardeve etike në media minon besimin e publikut dhe vërtetësinë e informacionit;
- mediat e besueshme, ndonjëherë janë viktime të masave të moderimit jotransparent dhe të tepruar nga platformat online.

Lista e mëposhtme e rekomandimeve i paraqitet për vëmendje publikut dhe qeverisë së Shqipërisë. Së bashku, ato formojnë një program gjithëpërfshirës për të siguruar një peizazh mediatik të pavarur, pluralist dhe të besueshëm në vend, dhe për të garantuar të drejtën e qytetarëve për informim. Këto rekomandime synojnë të kapërcejnë disa sfida strukturore me të cilat përballet i gjithë ekosistemi mediatik, dhe që aktualisht po kufizojnë aftësinë e tij për të lulëzuar.

Procesi i anëtarësimit në BE ofron një mundësi të papërsëritshme për Shqipërinë, që të përmirësojë legjislacionin dhe standardet për lirinë e shtypit, në mënyrë që të mbështesë në mënyrë efektive gazetarinë e lirë, të pavarur dhe të besueshme në vend. RSF mirëpret vendimin për të hapur një “Dialog të Strukturuar për Lirinë e Medias” midis mediave dhe autoriteteve publike mbi këto çështje, nën drejtimin e Dekanit të Fakultetit të Histori-Filologjisë, z. Mark Marku. Këto rekomandime synojnë të kontribuojnë në këtë proces.

Objektivat	Rekomandime për veprim	Standardet ndërkombëtare
I. Siguria e gazetarëve është e garantuar.	<ol style="list-style-type: none"> Forcimi i kuadrit ligjor ekzistues për të luftuar SLAPP-et, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: <ul style="list-style-type: none"> - Kërkimin që padia për shpifje të paraqitet fillimisht përmes një mekanizmi vetërregullues para se të shqyrtohet nga një gjykatë; - Futjen e mundësisë për refuzimin e hershëm të padisë nëse bazohet në motive qartësisht abuzive; - Sigurimin e një politike shtetërore për mjetet juridike në mbështetje të gazetarëve, viktime të padive SLAPP. 	Rekomandimet e Këshillit të Evropës për luftimin e përdorimit të SLAPP-ve (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike). ¹

¹ Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për luftimin e përdorimit të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).

	<p>2. Rishikimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues mbi mbrojtjen e konfidencialitetit të burimeve për të korrigjuar boshllëqet e identifikuar në vendimet e fundit gjyqësore dhe për të siguruar që gazetarët/viktimat e përpjekjeve të paligjshme, për t'iu zbuluar burimet, dhe të mbikëqyrjes së padrejtë të kenë mbështetje profesionale juridike.</p>	<p>Akti Evropian për Lirinë e Medias - neni 4²</p>
	<p>3. Miratimi i një Plani Kombëtar të Veprimit për Sigurinë e Gazetarëve (NAPSJ), që përfshin masa për të siguruar ndjekjen penale të krimeve kundër gazetarëve, (kapacitete të mjaftueshme, trajtim me prioritet, trajnim për autoritetet e zbatimit të ligjit etj.), siç rekomandohet në fushatën e Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve.</p>	<p>PersVeiling në Hollandë</p>
<p>II. Pavarësia dhe pluralizmi i medias është i mbrojtur nga ndërhyrjet e pajustificuara dhe censura.</p>	<p>4. Vendosja e një detyrimi ligjor për ofruesit e shërbimeve mediatike, që të adoptojnë masa për mbrojtjen e pavarësisë editoriale, veçanërisht për të garantuar që vendimet editoriale të merren pa ndërhyrjen e aksionerëve të mediave dhe që të shmangen konfliktet e mundshme të interesit.</p> <p>5. Vendosja e masave më të forta mbrojtëse për pavarësinë editoriale dhe financiare të medias publike (RTSH), duke përfshirë sigurimin e një buxheti të qëndrueshëm dhe afatgjatë dhe një procedure të pavarur për emërimin e drejtorit të RTSH-së dhe anëtarëve të Këshilli Drejtues.</p> <p>6. Vendosja e një detyrimi ligjor për ofruesit e shërbimeve mediatike, që të zbulojnë publikisht informacionin mbi pronarët e tyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke përfshirë pronësinë e tyre mbi biznese të tjera dhe përfituesit realë.</p>	<p>Akti Evropian për Lirinë e Medias - Neni 6</p> <p>Akti Evropian për Lirinë e Medias - neni 5 dhe Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi mirëadministrimin e medias publike. (2012)³</p>

² Rregullorja (BE) 2024/1083 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 prill 2024, që përcakton një kuadër të përbashkët për shërbimet mediatike në tregun e brendshëm dhe që ndryshon Direktivën 2010/13/BE (Akti Evropian për Lirinë e Medias).

³ Rekomandimi CM/Rec(2012)1 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi mirëadministrimin e medias publike.

<p>III. Mbështetet qëndrueshmëria afatgjatë e gazetarisë dhe restarurohet besimi i publikut në media.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 7. Aplikimi i stimujve ekonomikë (lehtësi tatimore, përjashtime nga kontributet e sigurimeve shoqërore, për krijimin e vendeve të reja të punës, kredi pa interes për të mbuluar kostot e certifikimit, falje të penalteteve tatimore etj), për mediat që angazhohen të ndjekin procesin e certifikimit të Journalism Trust Initiative (JTI). 8. Inkurajimi i sektorit bankar për të ofruar zgjidhje teknike të dizajnuara, për zhvillimin e abonimeve online në media. 9. Nxitja e komunitetit të biznesit për të mbështetur gazetarinë e besueshme duke rritur shpenzimet për reklama në mediat etike, të identifikuara si të tilla mbi bazën e standardeve të njohura të certifikimit si, JTI (Journalism Trust Initiative). 10. Rishikimi i legjislacionit ekzistues për të drejtën e autorit dhe shqyrtimeve gjyqësore për të siguruar një mbrojtje më efektive të përmbajtjes mediatike online, pa paragjykuar respektimin e lirisë së shprehjes. 	<p>“Appel de Villers-Cotterêts” - Për një hapësirë digjitale të vërtetë dhe të besuar në hapësirën frëngjishtfolëse.⁴</p> <p>Deklarata Ministrore e G20 - Kapitulli mbi “Integritetin e Informacionit Online dhe Besimin në Ekonominë Digjitale”⁵</p> <p>Shënim Udhëzues i Komitetit Drejtues të Këshillit të Evropës për Mediat dhe Shoqërinë e Informacionit ‘Luftimi i përhapjes së dezinformimit dhe keqinformimit online përmes verifikimit të fakteve dhe zgjidhjeve të dizajnit të platformave, në përputhje me të drejtat e njeriut’. (2023)</p>
--	--	--

4

<https://www.elysee.fr/emmanuel-macron/2024/10/04/appel-de-villers-cotterets-pour-un-espace-numerique-integre-et-de-confiance-dans-lespace-francophone>

⁵ Paragrafi 14 i Deklaratës: ‘(...) Paralelisht, promovimi i një ekosistemi dixhital të qëndrueshëm dhe të fortë, si dhe një mjedisi informacioni të larmishëm dhe rezistent, është thelbësor, duke përfshirë qasjen në informacion të pavarur, faktik dhe të bazuar në prova për të luftuar keqinformimin dhe dezinformimin (...)’